



ALEANCA PËR FËMIJËT SHQIPËRI



OBSERVATORI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE

KARTA RAJONALE RAPORTUESE – QARKU DIBËR

“Analiza e treguesve të rinj që monitorojnë të drejtat e fëmijëve” për vitin 2011



QARKU DIBËR

Eksperte Rajonale
Majlinda Hoxha

Lista e Shkurtimeve

DRSHS	– Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social
IT	- Information Technology (Teknologji informacioni)
DRSKSH	– Drejtoria Rajonale e Sigurimeve dhe Kujdesit Shëndetësor
DAR	– Drejtoria Arsimore Rajonale
DSHP	– Drejtoria e Shëndetit Publik
NJDF	– Njësia për të Drejtat e Fëmijëve
NJMF	– Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
VKM	– Vendim i Këshillit të Ministrave
Observatori	- Observatori për të Drejtat e Fëmijëve
DPGJC	– Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile
NE	– Ndihe Ekonomike
MPCSSHB	– Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
CU	– Cikli i ulët (klasat I-V)
UN	– United Nations (Kombet e Bashkuara)
ACA	– Albanian Children Aliance (Aleanca për Fëmijët Shqipëri)

I - Parathënie dhe falënderime

“Observatori për të drejtat e fëmijës” është një projekt i “Aleancës Shqiptare për Fëmijë”, i shtrirë në 12 qarqet e vendit, përfshirë edhe atë të Dibrës. Ky projekt synon ngritjen e mekanizmave të monitorimit të të drejtave të fëmijëve nga niveli lokal në atë kombëtar nëpërmjet mbledhjes, përpunimit, analizimit dhe vlerësimit të të dhënave statistikore.

Synimi Observatorit është përmirësimi i politikave lokale për fëmijë, në funksion të respektimit sa më të gjerë të të drejtave të tyre.

Në Dibër, Observatori tashme është një faktor i rëndësishëm në procesin e monitorimit të të drejtave të fëmijëve, por jo vetëm. Falë punës dhe angazhimit të cdo dite të Observatorit në Qarkun Dibër, është rritur ndërgjegjësimi lokal për të drejtat e fëmijëve lidhur me monitorimin nëpërmjet treguesve statistikore, të kombinuat me vlerësimin nëpërmjet pjesëmarrjes. Në këtë proces ndërgjegjësimi e bashkëpunimi, Observatori është vlerësuar jo vetëm si mjet për monitorimin e të drejtave të fëmijëve, por si një metodologji e cila mund të përdoret për monitorimin e politikave dhe strategjive të zhvillimit lokal në përgjithësi dhe integrimin e çështjeve që lidhen me të drejtat e fëmijëve në nivel lokale e rajonale.

Qarku Dibër në partneritet me UNICEF po e shtrin ngritjen e sistemeve të monitorimit për zhvillimin e qarkut në tërësi dhe treguesit për fëmijë do jenë pjesë e këtij sistemi. Kjo gjë jo vetëm tregon rëndësinë e punës së Observatorit dhe vlerësimin shumë pozitiv të kontributit të tij, por është një garanci e fortë për qëndrueshmërinë e këtij projekt sot dhe në të ardhmen.

Në punë e tij Observatori ka arritur të konsolidojë një bashkëpunim të ngushtë me të gjitha strukturat lokale dhe rajonale, OJF-të, shkollat, njësitë e qeverisjes vendore, komunitetin e nxënësve dhe prindërve, etj. Ky partneritet është i rëndësishëm, pasi secili nga partnerët e mësipërm ka një rol shumë të pazëvendësueshëm në respektimin e të drejtave të fëmijëve në shkollë, familje dhe komunitet.

Për kontributin e dhënë në përmbushje të misionit dhe detyrës së Observatorit Dibër, nga pozicioni i ekspertës rajonale shkon një falënderim për bashkëpunimin në këtë proces për Z. Shukri Shehu, Drejtor i DRSHS Dibër, Z. Ferdi Fida, menaxher i IT pranë DRSKSH Dibër, Z. Zenulla Mehmeti, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit, Integritit dhe Zbatimit Këshilli i Qarkut Dibër, Znj. Nevila Manga eksperte e NJDF qarku Dibër, Znj. Vafie Seferi Përgjegjëse e zyrës së statistikave DSHP Dibër, Znj. Roza Kurtaga Përgjegjëse e statistikave DAR Dibër, etj.

Një falënderimi i veçantë nga ekspertja e observatorit Dibër shkon për stafin e Aleancës për Fëmijët Shqipëri (ACA) dhe specifikisht Znj. Suzana Sakiqi, drejtuese e ACA, znj. Elma Tërshana, koordinatore kombëtare e Observatorit si dhe znj. Mina Mata, eksperte e menaxhimit të të dhënave për fëmijët.

Ndihma dhe kontributi i tyre i vazhdueshëm ka qenë mjaft i rëndësishëm jo vetëm për përgatitjen e këtij raporti, por dhe në gjithë punën e Observatorit Dibër që nga fillimi. Në sajë të mbështetjes së tyre janë siguruar një sërë të dhënash dhe partneritetesh me strukturat qendrore në Tiranë, si dhe është bërë i mundur përdorimi i eksperiencave më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare, eksperiencia të cilat është synuar të merren në konsideratë gjatë përgatitjes së këtij raporti.

II - Hyrja

Ky raport është produkt në vazhdim i punës së Observatorit Dibër për monitorimin e respektimit të të drejtave të fëmijëve në këtë qark. Qëllimi i studimi është vlerësimi i treguesve të rinj statistikore që monitorojnë të drejtat e fëmijëve në kontekstin lokal dhe problematikat që hasen në prodhimin e tyre, për vitin 2011.

Raporti synon që të bëj prezente, nga njëra anë analizën krahasuese të treguesve të rinj me ato të Observatorit të prodhuar deri tani dhe nga ana tjetër problematikat që hasen për sigurimin e informacioneve sipas këtyre treguesve.

Ashtu si dhe raportet e mëparshme të Observatorit ky raport synon t'ju vijë në ndihmë NJDF në qark, NJMF dhe personave përgjegjës në njësitë vendore që për shkak të detyrimit ligjor janë tashmë të përfshirë direkt në mbledhjen e informacioneve sipas treguesve të rinj. Gjithashtu raporti do synojë të japë sugjerimet konkrete se si mund të zgjidhen problemet që dalin në terren gjatë këtij procesi.

Në fakt për qarkun Dibër, ashtu si dhe për qarqet e tjera të vendit, ka raporte periodike statistikore analitike lidhur me të drejtat e fëmijëve. Treguesit e mbledhur nga terreni, Observatori i përpunon ato në data base duke përdorur sistemin DevInfo, sistem ky i certifikuar nga UN dhe që përdoret duke shënuar njëkohësisht një standard të rëndësishëm për vendet që e përdorin atë. Gjithsesi Observatori në punën e tij synon edhe dhënien e kontributit lidhur me përdorimin e integruar të standardeve ndërkombëtare (siç është sistemi i mësipërm i monitorimit) me ato kombëtare (siç janë treguesit e rinj të miratuar me vendimet përkatëse dhe të dhënat statistikore të prodhuara nga strukturat lokale dhe rajonale) që monitorojnë të drejtat e fëmijëve në të gjitha nivelet.

Është kjo arsyeja pse për vitin 2011, për qarkun Dibër u mendua përgatitja e këtij raporti, krahas përgatitjes së treguesve statistikore me të cilët Observatori punon që nga viti 2009.

Në fakt treguesit e përcaktuar lidhen me të drejtat e fëmijëve në përgjithësi, për rrjedhojë raporti do na japë këndvështrimin e përgjithshëm të situatës, pa iu referuar një kategorie të caktuar, brenda grupimit “fëmijë”.

Informacionet e përfshira në këtë raport vijnë nga institucionet lokale dhe rajonale Dibër (të dhënat statistikore), nga takime me grupe interesi në të 3 rrethet e qarkut si dhe nga takime e diskutime me ekspertë rajonalë sipas fushave të vlerësimit të treguesve.

Ashtu si dhe në raportet e mëparshme, edhe në këtë raport janë integruar të dhëna sasiore me informacione cilësore si dhe informacionet e marra direkt nga fëmijët, duke i ballafaquar ato me politikatat dhe standardet kombëtare e lokale, si një qasje që jep mundësi për të vlerësuar progresin dhe çështjet kritike deri në nivel njësie vendore.

Duke qenë se ndër vite, mjaft struktura dhe organizata janë marrë me çështjen e të drejtave të fëmijëve, faza e parë e përgatitjes së raportit ishte konsultimi me këto dokumente të cilat kanë shërbyer si bazë analize, referimi dhe krahasimi.

Dokumentet e përdoruar kanë qenë ligje, VKM, raportet vjetore të Observatorit, strategji dhe politika rajonale, raporte të organizatave të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare. Më shumë informacion rreth materialeve që Observatori Dibrë u është referuar, i gjeni te Bibliografia.

Përgatitja e këtij raporti u bë nëpërmjet një procesi që në vetvete kishte 2 komponentë kryesor, të dhënat statistikore dhe informacionet e marra nga takimet me fokus grupet. Për qarkun e Dibrës u organizuan takime me 4 fokus grupe me të rritur (përkatësisht ne komunën Kastriot dhe ne qytetin e Peshkopisë, ne bashkitë Bulqizë dhe Burrel) ku morën pjesë në total 48 pjesëmarrës. Me grupe nxënësish u realizuan 3 takime, në të cilën morën pjesë në total 32 nxënës. Takimet me nxënës u zhvilluan ne bashkinë Peshkopi (me nxënës te shkollave 9-vjeçare) si dhe një takim me nxënës te vitit te pare te shkollës se mesme “Nazmi Rushiti”. Gjithashtu një takim me nxënës u zhvillua ne shkollën 9-vjeçare Sohodoll (komuna Kastriot). Nxënësit e fokus grupit ne shkollën e mesme Peshkopi vinin nga komuna te ndryshme, duke sjellë në takim jo vetëm këndvështrimin e tyre për te drejtat e fëmijëve deri në periudhën e pjesëmarrjes në takim, por njëkohësisht edhe situata e te drejtave te fëmijëve në komunitetet nga ato vijnë, duke qenë se nuk kanë shumë kohë që janë me studime në Peshkopi. Gjithashtu ato kane qenë nxënës në shkollën 9-vjeçare gjatë vitit që ky raport studimi analizon të dhënat (viti 2011).

Gjithsej në takimet me grupet fokus morën pjese 48 te rritur nga 3 rrethet , 32 fëmijë nga 10 njësi vendore ne Dibrë.

Informacionet e marra nga takimet janë pjese e gjetjeve të këtij raporti. Çështjet në të cilat u fokusuan intervistat me fokus grupet ishin:

1. A keni diskutuar ndonjëherë për të drejtat e fëmijëve:
2. Cili është institucioni/institucionet qe është/janë PERGJEGJES për njohjen dhe respektimin e te drejtave te fëmijëve ne komunitetin ku jetoni?
3. Si e vlerësoni te drejtën e fëmijëve për arsim ne njësinë tuaj vendore?
4. Çfarë është mirë/ shumë mirë?
5. Cilat janë problemet kryesore?
6. Sa shkojnë shërbimet shëndetësore tek fëmijët?
7. Gjendja e infrastrukturës dhe gatishmëria e personelit shëndetësor.
8. A dini raste të pamundësisë se familjeve për te ndjekur problemet shëndetësore të fëmijëve te tyre jashtë zonës?
9. Si e vlerësoni situatën ekonomike të familjeve të njësisë suaj?
10. Në ç’masë familja mundet të plotësoja nevojat e fëmijëve në përgjithësi?
11. A janë fëmijët pjese e vendimmarrjes, si?

Pavarësisht punës së bërë, raporti ka kufizimet e veta.

- Ai bëhet për treguesit e rinj, të cilët në disa raste janë ndryshe nga treguesit e prodhuar nga Observatori në bashkëpunim me strukturat lokale. Kjo krijon vështirësi në gjetjen e të gjitha të dhënave për përgatitjen e informacioneve të duhura.
- Të dhënat cilësore (narrative) kanë qenë të kufizuara, për shkak të mundësive të limituara të përfshirjes së fëmijëve dhe të rriturve në nivel qarku. Për rrjedhojë interpretimi i treguesve është e mundur të jetë më i gjerë se sa paraqet raporti.
- Duke qenë se formulari sipas ligjit të mësipërm i përgatitur synon monitorimin dhe vlerësimin për politik-bërjen në nivel kombëtar, treguesit janë deri në nivel qarku. Kjo bën që raporti të vlejë për krahasim në këtë nivel, pa dhënë mundësinë e evidentimit të situatës në nivel njësisish vendore (komuna dhe bashkitë përkatëse të Qarkut).

Gjithsesi ai do jetë një mënyrë e të parit të të drejtave të fëmijëve, krahasuar me punën e bërë nga Observatori deri tani. Gjithashtu përgatitja e tij bazuar në tregues të miratuar nga qeveria shqiptare është një bazë e mirë për të rritur bashkëpunimin mes Observatorit dhe Qarkut, si struktura përgjegjëse në nivel lokal për të mbledhur të dhënat dhe të vlerësojë realizimin e të drejtave të fëmijëve bazuar në këto tregues.

III - Analiza e situatës së të drejtave të fëmijëve bazuar ne treguesit e parashikuar ne ligj

1. Përshkrim i përgjithshëm i situatës së të drejtave të fëmijëve në nivel Qarku

Dibra është ndër rajonet në të cilët vlerësimi i situatës lidhur me respektimin e të drejtave të fëmijëve ka filluar që në vitin 2008 e në vazhdim. Sipas të dhënave të marra nga DPGJC Tiranë, për vitin 2011 qarku Dibër ka pasur një popullsi të regjistruar prej 179,108 banorësh në 3 rrethet e tij, Bulqizë, Dibër dhe Mat.

Nga të dhënat periodike që disponohen nga Observatori Dibër, qarku ka një popullsi me dinamike rritje të qëndrueshme në vitet e fundit. Fëmijët janë një grupmoshe e konsiderueshme brenda popullsisë së rajonit/qarkut. Për vitin 2011 qarku Dibër ka pasur 53,809 fëmijë 0-18 vjeç. Ndaj numrit total të banorëve, fëmijët, për vitin 2011 zënë 30 % te popullsisë në nivel qarku.

Mirëqenia dhe interesi më i lartë i fëmijëve, është boshti i analizës së mëposhtme në këtë raport. Nga pikëpamja sociologjike dhe psikologjike mirëqenia përshkruhet me termin e “kënaqësi ndaj jetës” dhe të “lumturisë” që çdo individ ka arritur, krahasuar me aspiratat dhe synimet e projektuara¹.

Pavarësisht punës së bërë nga të gjithë aktoret lokale dhe kombëtarë, fëmijët vazhdojnë të jenë një grup *pak i vlerësuar dhe përfaqësuar* kur vjen puna për respektimin e të drejtave të tyre. Mentaliteti mbetet një problem, që ndikon negativisht në konsiderimin e fëmijëve si partnerë brenda familjes dhe në komunitet.

Gjithashtu niveli ekonomik është një tjetër faktor që ndikon në fokusimin e pakët tek njohja dhe respektimi i të drejtave të fëmijëve. Problemet e jetesës nga njëra anë e bëjnë të vështirë vendosjen e një komunikimi të vazhdueshëm dhe funksional mes prindërve dhe fëmijëve, nga ana tjetër mundësitë e familjeve për të marrë në konsideratë nevojave e fëmijëve që lidhen me burime financiare janë të kufizuara.

Në përgjithësi fëmijët kanë vëmendje maksimale sidomos brenda familjes, por rruga e zgjedhur nuk është ajo e duhur. Përgjithësisht marrëdhëniet me fëmijët orientohen drejt komunikimit formal dhe të ftohtë/urdhërues, se sa njohja e tyre dhe nga ana e prindërve dhe familjes në tërësi.

Një situatë e ngjashme është edhe përsa u përket të drejtave të fëmijëve në komunitet². Si pjesë e njësisive vendore, lagjet dhe mëhallat nuk ka ambiente çlodhëse dhe argëtuese për fëmijët, duke bërë që ato të mos kenë mundësi jo vetëm të realizojnë dëshirat e moshës, por dhe të socializohen apo të shpenzojnë energjitë e tyre në mënyrë pozitive.

¹ Matja e mirëqenies së fëmijëve në Shqipëri duke përdoruar vërtetimet MICS dhe ADHS, V Kolpeja,

² World Vision studim “ Raport vlerësimi për situatën e mjedisit të shëndetshëm dhe paqësor për fëmijët në rajonin e Dibrës” mars – prill 2010

2. Aksesit ndaj shënimeve sociale të ofruara për të plotësuar nevojat dhe problemet e fëmijëve

Treguesit e monitoruar nga Observatori janë në një numër të konsiderueshëm dhe në vazhdimësi gjatë viteve të fundit³. Gjithsesi me poshtë në raport do prezantohet situata e të drejtave të fëmijëve në qarkun e Dibrës sipas treguesve të miratuar për monitorimin e të drejtave të fëmijëve në ligjin 10 347, datë 4.11.2011.

Siç u përmend më lart, tashmë monitorimi i të drejtave të fëmijëve është parashikuar në ligj, duke ngritur kështu edhe strukturat institucionale dhe mekanizmat për këtë qëllim⁴. Në këtë kuadër në qarkun e Dibrës është ngritur dhe po konsolidohet në vazhdimësi NJDF, e cila po bashkëpunon me të gjitha strukturat dhe aktoret lokal në drejtim të monitorimit të të drejtave të fëmijëve⁵.

Analiza e treguesve do bëhet sipas 8 fushave kryesore si me poshtë.

- Tregues demografike
- Tregues të varfërisë monetare (varfëria absolute)
- Tregues të përkujdesjes social
- Tregues të shëndetit
- Tregues të dhunës në familje, trafikimit, gjakmarrjes dhe mbrojtjes
- Tregues të drejtësisë për të miturit
- Tregues të punësimit të fëmijëve
- Tregues të arsimimit të fëmijëve

Bazuar në këto tregues të grupuar, aksesit i fëmijëve në Dibër është si më poshtë.

➤ Tregues demografikë

Për vitin 2011 në qarkun e Dibrës numri i fëmijëve ishte 53,809⁶ gjithsej ose 30 % e popullsisë totale në qark (Sipas DPGJC Tiranë). I ndarë sipas grupmohave numri i fëmijëve jepet në grafikun e mëposhtëm:


Burimi : Dr. Përgj. Gjendjes Civile Tiranë

³ Raportet vjetore, Observatori Tirane, 2008, 2009 dhe 2010

⁴ VKM 265, date 12.4.2012 “Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore, përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij”.

⁵ VKM 266, date 12.4.2012 “Për bashkërendimin e veprimtarisë së mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështje që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”;

⁶ Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Ministria e Brendshme Tirane, mars 2012;



Grafiku 1: Ndarja në grupmosha e popullsisë së Qarkut Dibër, viti 2011

Janë 14,394 fëmijë gjithsej që i përkasin grupmoshës 0-6 vjeç, e shprehur në % ky numër zë rreth 25 % të numrit total të fëmijëve.

28,193 fëmijë i përkasin grupmoshës 6-15 vjeç, ose rreth 49 % e numrit total të fëmijëve.

Ndërsa grupmoshës 6-15 vjeç i përkasin 15,016 fëmijë, ose rreth 26 % të fëmijëve.

Nga grafiku duket qartë që gati gjysma e fëmijëve janë në arsimin e detyruar. Po ashtu fëmijët në arsimin parashkollor (kopshte) dhe në arsimin e mesëm janë në numër të konsiderueshëm në Dibër.

Në fakt numri i fëmijëve i përdorur me sipër është marrë nga Drejtoria e përgjithshme e gjendjes civile (DPGJC) në Tiranë. Në nivel qarku numri i fëmijëve në total dhe sipas njësive vendore nuk rezulton si e dhënë pasi zyrat e gjendjes civile pranë njësive vendore nuk e kanë aktive atë pjese të sistemit që bën të mundur nxjerrjen e të dhënave nga regjistrat e popullsisë. E njëjta gjë vlen edhe me ndarjen e numrit të fëmijëve sipas gjinive, ky informacion akoma nuk është i disponueshëm si e dhënë bazë për Qarkun e Dibrës (përfshirë ndarja në njësi vendore) deri tani.

Lidhur me numrin e familjeve për vitin 2011⁷, sipas të dhënave të DPGJC Tirane, qarku ynë në këtë vit ka të regjistruara 48,291 familje gjithsej, nga të cilat rrethi Bulqizë ka 11,626 familje, rrethi Dibër 20,874 familje dhe rrethi Mat 15,791 familje.

Rreth 10341.5 familje me fëmijë janë mbështetur me NE në qarkun e Dibrës për vitin 2011. Nuk ka të dhëna për ndarjen e familjeve sipas numrit të fëmijëve qa kanë kategoritë brenda totalit të familjeve në NE (nuk ka të dhëna sa familje në NE kanë 1, 2, 3 apo më shumë fëmijë) sipas kërkesës së treguesit të përcaktuar në listën e treguesve të miratuar (VKM 276, date 12.4.2012). Nga numri i mësipërm i familjeve në NE rreth 916 familje janë me një prind dhe drejtohen nga kryefamiljare gra. Nuk ka të dhëna që fëmijët jetojnë vetëm me të atin. Familjet në të cilat kontributi prindëror është vetëm nga nëna, përballen me probleme të tjera. Ndryshimet në strukturën e familjes kanë ndikim në mirëqenien e fëmijës. Fëmijët në familje një-prindërore kanë risk më të lartë për të pasur zhvillim psiko-social më të ulët krahasuar me fëmijët që jetojnë me të dy prindërit⁸.

Në nivel qarku për vitin në raportim , nga 28,193 fëmijë që ndjekin arsimin e detyruar, rreth 17,122 prej tyre ose 60.7 % e fëmijëve 6-15 vjeç jetojnë në familje të NE.

➤ **Tregues të varfërisë monetare (varfëria absolute)**

Sipas të dhënave zyrtare periodike (referuar INSTAT), Dibra është ndër rajonet me nivel të ulët ekonomik. Numri i madh i familjeve në NE është një ndër treguesit për këtë. Megjithatë nuk ka të dhëna që lidhen me varfërinë absolute në nivel njësisish vendore. Kjo pasi nuk ka një metodologji

⁷ Te dhena te siguruar nga Observatori Kombetar, Tiranë Mars 2012;

⁸ Matja e mirëqenies në Shqipëri duke përdorur vrojtimit MIC3 dhe ADHS, V. Kolpeja;

zyrtare të aprovuar për matjen e treguesve që lidhen me këtë çështje⁹. Nga diskutimet me fokus grupet në të tre rrethet e qarkut Dibër, mendohet që ka familje të cilat jetojnë në kushtet e varfërisë ekstreme, por nuk ka statistika apo vlerësime periodike për numrin apo përqindjen e kësaj kategorie ndaj totalit. Për shkak të zotërimit të një sipërfaqe toke, disa prej tyre nuk janë as në skemën e NE, pavarësisht faktit që sipërfaqja mund të jetë e pakët dhe aftësitë prodhuese e tokës të jetë e ulët.

Gjithsesi nga të dhënat e marra në nivel qarku pranë DRSHS Dibër rezultojnë që për vitin 2011 rreth 63 % e fëmijëve konsiderohen të varfër. Nga këto 16 % jetojnë në zonat urbane të qarkut, ndërsa 47 % jetojnë në zonat rurale¹⁰.

➤ ***Tregues të përkujdesjes social***

Nga informacionet dhe të dhënat e marra nga DRSHS Dibër, rezultojnë që shërbimet e përkujdesjes social për fëmijët në nivel qarku janë shumë të pakta. Në rrethet Bulqizë dhe Dibër nuk ka iniciativa të mirëfillta të ofrimit të shërbimeve specifike për fëmijët sipas problematikave të tyre.

Fëmijët me nevoja të veçanta janë ndër kategoritë e fëmijëve të cilët kanë nevojë për përkujdesje të veçantë sociale. Bazuar në “DISPOZITA NORMATIVE” për “Për arsimin parauniversitar”, në KREU VIII “FËMIJA PARASHKOLLOR DHE NXËNËSI”, Neni 36 “Të drejtat”, pika 7 thuhet që: “Fëmijët me aftësi të kufizuara mendore apo fizike të rënda, në pamundësi të trajtohen në shkollat e veçanta, mund të trajtohen në institucione të tjera, sipas rastit”.

Nga informacionet e marra pranë DRSHS Dibër, rezultojnë që si qark janë 3,180 persona të cilët janë në skemën e mbështetjes me fond sipas legjislacionit në fuqi. Megjithatë numri i fëmijëve nuk është plotësisht i ndare. Sipas ligjit shqiptar¹¹ grupmoshat për personat me nevoja të veçanta janë 0-3, 4-16, 17-21, etj. Kjo bën që të mos kemi informacion për fëmijët 17-18 vjeç që janë me nevoja të veçanta.

Për vitin 2011 bazuar në informacionin e mësipërm rezultojnë që, janë 375 fëmijë 0-3 vjeç me nevoja të veçanta, nga të cilët 236 fëmijë e kanë aftësinë e kufizuar të lindur dhe 139 fëmijë e kanë të fituar.

Nga grupmosha 4-16 vjeç janë 962 fëmijë me AK nga të cilët 581 fëmijë e kanë të lindur ndërsa 381 fëmijë e kanë fituar gjatë jetës.

Megjithëse në Peshkopi është një shoqatë për fëmijët me nevoja të veçanta, nuk është bërë e mundur ofrimi i shërbimeve reale për këto fëmijë.

Aktivitetet me këta fëmijë janë sporadike dhe zhvillohet në ambientet dhe nga personeli që trajtojnë personat me probleme të shëndetit mendor.

Parë në këtë këndvështrim, dhe në konsultim me drejtues të DRSHS Dibër, thuhet që ky shërbim nuk mund të konsiderohet si përkujdesje sociale për fëmijët me nevoja të veçanta në Dibër.

Për rrjedhojë ai nuk është i licensuar nga strukturat përkatëse të MPCSSHB.

⁹ Profili i varfërisë së fëmijëve në Shqipëri, A. Ceni, UNICEF 2011

¹⁰ DRSHS Dibër, Statistika 2011, Prill 2012

¹¹ Ligji Nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.

Rast

E. është një vajzë 7 vjeçare. Prej 3 vitesh familja e ka diagnostikuar me autizëm. Në fillim familja ishte e shokuar me këtë fakt, megjithatë ato kanë bërë përpjekje maksimale për ta zgjidhur këtë problem të E. Prindërit duhet të punojnë për të siguruar të ardhura për shërimin e vajzës.

Ato janë përpjekur të gjejnë struktura të specializuara për fëmijët autik me të cilat të bashkëpunojnë, por nuk kanë mundur. Për ta është shpesh e vështirë të bëjnë me të mirën për vajzën e tyre, pasi nuk kanë informacionin dhe aftësitë e duhura ta menaxhojnë situatën në çdo rast.

Në rrethin e Matit me mbështetje të Qendrës “Në dobi të gruas shqiptare” funksionon qendra ditore “Lulet e mollës”, e cila ofron shërbime për fëmijë nga familje me probleme sociale si varfëria, dhuna në familje, fëmijë me prindër të ndare etj. Krahas shërbimit të ofrimit të një vakti ushqimor (të drekës) për 60 fëmijë, në këtë qendër zhvillohen edhe aktivitete të tjera në interes të fëmijëve të grupmoshës 7-14 vjeç të cilët frekuentojnë këtë qendër.

Lidhur me fëmijët e akomoduar në qendrat rezidenciale, për vitin 2011 nuk ka raste të reja në nivel qarku. Gjithsesi rezultojnë të sistemuar në Shtëpinë e fëmijës Shkodër 3 fëmijë nga rrethi Dibër, të cilët janë akomoduar në vitin 2010¹². Arsyeja e sistemimit të këtyre fëmijëve në këtë institucion, ishin problemet sociale brenda familjes të cilat çuan në braktisjen e tyre nga ana e prindërve pas divorcit.

Duhet thënë që akomodimi i tyre është bërë nga DRSHS Dibër në partneritet me strukturat e tjera përgjegjëse dhe DRSHS ndjek ecurinë e tyre në mënyrë periodike në këtë institucion.

Për vitin 2011 në nivel qarku nuk ka pasur raste të fëmijëve të birësuar apo të vendosur në familje kujdestare.

➤ Tregues të shëndetit

Nga takimet me drejtues lokalë dhe fokus grupet si dhe bazuar në treguesit statistikore rezulton që ka një mbulim të mirë me struktura dhe personel të shërbimit shëndetësor në Dibër. Në nivel qarku janë 35 konsultore¹³ të nënës dhe fëmijës të cilat ofrojnë shërbime në gjithë komunitetin e qarkut.

Nga vëzhgimet në terren si dhe nga informacionet e marra në takime me fokus grupet rezulton që personeli shëndetësor është fleksibël në ofrimin e shërbimeve, duke alternuar shërbimet pranë strukturave shëndetësore me shërbimet pranë familjes sipas mundësive të pacienteve. Gjithashtu bëhet një punë shumë e mirë lidhur me vaksinimin. Për vitin 2011, nga të dhënat e marra në DSHP Dibër, rezulton që vaksinimet sipas parashikimeve në ligj kryhen në masën mbi 99 %. Kjo gjë është bërë praktike e konsoliduar tashmë.

Megjithatë edhe për treguesit e shëndetit nuk ka informacione të plota në nivel qarku. Megjithëse është DSHP Dibër që mbulon qarkun, zyrat përkatëse në Bulqizë dhe Mat nuk raportojnë pranë DSHP Dibër, por komunikimin normal e kanë me Ministrinë e Shëndetësisë. Kjo e bën të vështirë marrjen e informacioneve të plota lidhur me treguesit e shëndetit për Dibrën.

¹² DRSHS Dibër, Statistika 2011, Prill 2012

¹³ DRSKSH Dibër, Statistika 2011, Maj 2012

Nga ana tjetër një pjesë e banorëve të qarkut (sidomos nga komunat periferike) marrin shërbime në Tiranë apo rajone të tjera të vendit për shkak të lehtësirave në lëvizje. Ky është një tjetër aspekt që ndikon në të dhënat mbi shëndetin.

Gjithsesi janë disa grupe të dhënash për të cilat informacioni zyrtar mungon pothuaj plotësisht. Një grup i tillë janë personat me HIV/AIDS. Zyrtarisht ky numër nuk është i evidentuar. Kjo pasi nuk ka pasur persona të cilët të kenë kërkuar ndihme për këtë problem pranë strukturave në Dibër. Zakonisht këto persona kërkojnë trajtim pranë strukturave të specializuara në Tiranë. Një gjë e tillë e bën të vështirë marrjen e informacioneve edhe për strukturat shëndetësore në nivel qarku, pasi strukturat që i asistojnë janë të detyruara të ruajnë anonimatën e personave të prekur me HIV/AIDS, për rrjedhojë nuk japin informacion zyrtar për këtë çështje. Por duhet thënë se janë 3 persona të prekur nga kjo sëmundje të cilët trajtohen në Tiranë. Mes tyre ka edhe fëmijë të prekur të cilët e kanë marrë nga prindërit.

➤ **Tregues të dhunës në familje, trafikimit, gjakmarrjes dhe mbrojtjes**

Duhet thënë se dhuna në familje është një fenomen që ndeshet jo rrallë në Dibër. Pjesë e kësaj situatë janë dhe fëmijët. Megjithatë në nivel komuniteti dhe familje dhuna ndaj fëmijëve unifikohet vetëm me dhunën fizike ndaj tyre, ndërsa format e tjera nuk konsiderohen e pranishme dhe nuk njihen si problem ¹⁴. Por deri tani nuk ka të dhëna statistikore lidhur me shkallën e përdorimit të formave të ndryshme të dhunës në familje dhe komunitet dhe që atakon fëmijët.

Përveç dhunës në Dibër ndeshet si fenomen edhe trafikimi i fëmijëve. Nga takimet me grupe të ndryshme në komunitete prezantohen raste konkrete sidomos të vajzave nën 18 vjeç të cilat trafikohen në rajonet urbane të vendit. Megjithatë për shkak të presionit të komunitetit, familjet nuk i denoncojnë raste të tilla duke mos folur për këtë gjë.

Dibra është një komunitet paqësor, pavarësisht problemeve ekonomike dhe sociale me të cilat përballen komunitetet rurale. Gjakmarrja nuk është një fenomen që haset shpesh në Dibër. Brenda komuniteteve nuk ka presion në sensin negativ ndaj familjeve që kanë probleme të kësaj natyre.

Lidhur me mbrojtjen e fëmijëve gjatë vitit 2011 janë shënuar hapa të rëndësishëm pozitive. Në nivel qarku ka funksionuar NJDF dhe kanë qenë aktive edhe 2 NJMF në njësitë vendore¹⁵.

Nga informacionet e marra, modeli më pozitiv në nivel qarku është bashkia Peshkopi, në të cilën NJMF ka vazhduar me identifikimin dhe asistimin e rasteve konkrete të fëmijëve me probleme.

Gjatë vitit 2011 nga NJMF Peshkopi janë mbështetur këto raste si më poshtë :

Tabela 1: Rastet e mbështetura dhe raportuara nga NJMF Peshkopi, viti 2011

Burimi: NJMF Peshkopi, 2011

Nr.	Rastet	Nurmi i rasteve
1.	Dhunë ndaj gruas në familje me fëmijë prezent	15
2.	Fëmijë të dhunuar fizikisht	5
3.	Fëmijë të cilët kanë braktisur shkollën	2
4.	Fëmijë jetim	2
5.	Fëmijë në konflikt me ligjin	1

¹⁴ Observatori Dibër, Raportet vjetore 2008, 2009 dhe 2010.

¹⁵ Në bashkinë Peshkopi dhe komunën Tomin

Për secilin nga rastet e Tabelës 1 jo vetëm është dhënë asistenca e nevojshme, por janë hapur dosje të posaçme dhe secili rast është ndjekur në vazhdimësi nga punonjësja e NJDF. Të gjitha rastet e paraqitura me sipër kanë marrë zgjidhje me mbështetjen e NJM Peshkopi dhe në partneritet me aktorëve lokal dhe rajonal¹⁶. Kjo zyrë sipas nevojave ka përfaqësuar të miturin në konflikt me ligjin në Gjykatë dhe ka ndjekur rastin deri në përfundimin me sukses të tij.

➤ **Tregues të drejtësisë për të miturit**

Treguesit e drejtësisë për fëmijë ashtu si dhe në disa grupe të tjera treguesish janë me informacione të limituara dhe të rezervuara. Gjithashtu nuk ka ndarje informacioni mes strukturave të policisë ndërmjet rretheve në qark. Pavarësisht se përfaqësues të strukturave policore dhe gjyqësore janë pjesë e aktiviteteve rajonale që synojnë mbrojtjen më të mirë të fëmijëve, informacionet që ato disponojnë për fëmijët konsiderohen si kategori që nuk mund të bëhet publike.

Është kjo arsyeja pse në këtë raport ato nuk janë të përfshira. Gjithsesi sigurimi i statistikave edhe në këta tregues është ndër synimet e punës së Observatorit në vazhdim.

➤ **Tregues të punësimit të fëmijëve**

Punësimi është një çështje për diskutim në qarkun e Dibrës. Niveli i ulët ekonomik në familje dhe emigrimi i prindërve në mjaft raste kërkojnë angazhim të madh nga ana e fëmijëve. Megjithatë në nivel rajonal vlera e shkallës së punësimit të fëmijëve në numër është “0”.

Puna e fëmijëve ndeshet në grumbullimin e bimëve mjekësore, mbledhjen e kromit (në Bulqizë) si dhe shitjen e prodhimeve të fermës përgjatë rrugës nacionale Bulqizë-Burrel.

Rast

N, S dhe D janë 3 motra nga një fshat i rrethit Dibër. N është në klasën e shtatë, D është në klasë të katërt, ndërsa S është në klasën e dytë. Babai i tyre punon si mekanik ndërsa nëna është shtëpiake.

Ato mësojnë në shkollën e fshatit të tyre, por për shkak të lëvizjes së banorëve nga fshati, të tria vajzat mësojnë në klasa të kombinuara. Nëna është ajo që ndihmon vajzat të bëjnë mësimet në shtëpi, por shpesh edhe ajo nuk është në gjendje t’ju shpjegojë gjërat e paqarta siç duhet, pasi programet janë në nivel të pakuptueshme për të.

Babai punon, por të ardhurat që ai sjell në shtëpi janë të pakta. Ndonjëherë ai konsumon alkool dhe vjen në shtëpi në gjende të dehur.

Nëna e tyre bën të gjitha përpjekjet t’ju krijojë kushte normale vajzave, por e ka të vështirë. Gjatë periudhës pranverë-vjeshtë ajo i merr vajzat dhe bashkë dalin e mbledhin bimë mjekësore. Ato sigurojnë të ardhura nga shitja e bimëve dhe me to blejnë librat dhe mjetet shkollore që ju nevojiten.

Fëmijët gjithashtu bëjnë punë në shërbim të familjes, kryesisht kullotjen e bagëtive, punojnë në punët e bujqësisë sipas nevojave. Megjithatë nga kjo kategori punësh nuk ka një ndarje të qartë se cilat janë punë me risk dhe cilat jo.

Ne rastin e bimëve mjekësore fëmijët përgjithësisht shoqërohen nga prindërit gjatë procesit, gjithsesi kjo ndodh kryesisht gjatë periudhës së pushimeve të verës. Një pjesë e mirë e të ardhurave të siguruar nga prindërit dhe fëmijët në këtë rast përdoren për përgatitjen e fëmijëve për shkollë në vitin në vazhdim.

¹⁶ NJMF Peshkopi, Raporti vjetor 2011

Shqetësues është fakti që në qytetin e Bulqizë, pranë zonës së minierës fëmijët angazhohen në mbledhjen e kromit, bashkë me prindërit ose edhe vetëm. Jo vetëm për shkak të terrenit mjaft të vështirë dhe të rrezikshëm, por dhe të natyrës së punës (grumbullimit të gurëve të kromit) përfshirja e fëmijëve në këtë rast është me mjaft rrezik. Megjithatë kjo çështje është bërë problem jo vetëm nga strukturat lokale e rajonale, por dhe nga media, ai nuk ka gjetur zgjidhje. Nga diskutimet me përfaqësues të strukturave në Bulqizë, mësohet se qyteti dhe fshatrat përreth kanë shumë probleme në aspektin ekonomik. Në Bulqizë përveç minierës, ka shumë pak aktivitete të tjera ekonomike. Kjo si dhe fakti që të ardhurat që sigurohen nga prindërit janë shumë të pakta, bën të domosdoshëm edhe angazhimin e fëmijëve. Nuk ka të dhëna numerike mbi numrin e fëmijëve të angazhuar në këtë punë.

Një situatë e ngjashme shihen edhe në rrethin e Matit përgjatë rrugës nacionale Peshkopi – Tiranë në segmentin Klos – Burrel. Gjatë verës dhe vjeshtës mjaft fëmijë angazhohen në shitjen e produkteve të ndryshme nga ferma për pasagjerët e automjeteve të linjës së mësipërme. Gjatë punës, fëmijët janë gjatë gjithë kohës të ekspozuar ndaj aksidenteve, pasi aktiviteti i tyre ushtrohet në rrugë nacionale me një intensitet të lartë të lëvizjes së automjeteve të të gjitha llojeve.

➤ ***Tregues të arsimit të fëmijëve***

Treguesit e arsimit për fëmijët, janë treguesit me të plotë për nga informacioni i prodhuar sipas listës së treguesve të miratuar për fëmijë, ligji 10347, VKM 267, datë 12.04.2012. Megjithatë vihet re e njëjta vështirësi si dhe në fushat e tjera që lidhen me statistikat në nivel vendor, strukturat e arsimit në rrethe jo detyrimisht sjellin informacione pranë DAR Dibër.

Në nivel qarku për vitin 2011, sipas të dhënave të marra në DAR Dibër, numri total i nxënësve që kanë përfunduar arsimin fillor ka qenë 11,960¹⁷ nxënës, nga të cilët 5,549 janë vajza dhe pjesa tjetër djem. Konvertuar në përqindje përfundojnë arsimin fillor 98.7 % e nxënësve që e frekuentojnë atë. Ndërsa numri i vajzave që kalojnë ndaj totalit të vajzave gjithsej në arsimin fillor është 98.8 %.

Numri i nxënësve në klasa në ciklin e ulët të arsimit të detyruar sipas të dhënave të përllogaritura nga punonjësit e statistikave pranë DAR Dibër, është mesatarisht 12.6 nxënës në klasë. Në llogaritjet për këtë tregues është marrë parasysh edhe fakti që një numër nxënësish mësojnë në klasa të kombinuara (klasa në të cilat nxënësit sipas moshës u përkasin klasave shkollore të ndryshme, por që mësojnë në të njëjtën klasë fizike dhe mësimi zhvillohet nga i njëjti mësues gjatë të njëjtit orar të ditës), duke e parë këtë si një mundësi reale për të krijuar mundësi për çdo nxënës të ndjekë arsimin sipas rrethanave dhe vendndodhjes.

Klasat e kombinuara ndeshen në mjaft njësi vendore në qark, për shkak të uljes së numrit të banoreve si rezultat i lëvizjes demografike të popullsisë të ndodhur gjatë viteve të mëparshme. Të mësuarit në këto klasa dekurajon prindërit dhe nxënësit për të shkuar në shkollë¹⁸. Klasat e kombinuara janë më të pranishme në komunat periferike të qarkut si Selishte, Zall Reç, Zall Dardhë, Lurë, Ostren, Trebisht, Rukaj, Ulëz.

Përveç numrit të nxënësve, një tjetër tregues me ndikim në cilësinë e të nxënësve në shkolle është edhe ngarkesa e mësuesve. Sipas të dhënave në nivel qarku numri i nxënësve për çdo mësues në ciklin e ulët sipas rretheve jepet në tabelën e mëposhtme.

¹⁷ DAR Dibër, Statistika 2011, Dhjetor 2012

¹⁸ Profili i varfërisë së fëmijëve në Shqipëri, A. Ceni, UNICEF 2011

Tabele 2: Numri mesatar i nxënësve për mësues ne CU , Dibër 2011

Burimi : DAR Dibër

Nr	Rrethi	Nx/mësues
1-	Bulqizë	12.6
2-	Dibër	17.9
3-	Mat	17.3

Sipas tabelës 2 duket që në qarkun e Dibrës në përgjithësi ka një ngarkese jo të lartë të mësuesve në CU, duke ndikuar pozitivisht në menaxhimin e klasës dhe organizimin cilësor të mësimin.

Në Dibër dhe Mat një mësues ka mesatarisht në klasë 17.9 dhe 17.3 nxënës, ndërsa në rrethin e Bulqizë kjo ngarkese është 12.6 nxënës /mësues¹⁹.

Gjithsesi ka diferenca të mëdha mes zonave urbane dhe atyre rurale në secilin rreth.


Në qytete ky ndryshim shkon deri në dyfishim të këtyre vlerave mesatare nëpër shkollat e qyteteve. Ndërsa ky tregues i matur në nivel qarku është 16.7 nxënës për mësues në klasat e ciklit të ulët. Në ciklin e lartë ngarkesa e mësuesve është 13.5 nxënës.

Ndryshime vihen re gjithashtu edhe në numrin mesatar të nxënësve në klasa në ciklet e arsimit të detyruar. Ky tregues në nivel qarku rezulton 12.6 nxënës/ klasë në CU dhe 15 nxënës/klasë në ciklin e lartë. Kjo diference vjen nga fakti që CU është me një shpërndarje më të gjerë dhe më afër komuniteteve, ndërsa shkollat e ciklit të lartë janë më të grupuara dhe me numër më të madh nxënësish.

Në qarkun e Dibrës janë të angazhuar një numër i konsiderueshëm mësuesish. Në ciklin e ulët japin mësim 699 mësues nga të cilët 450 janë femra, ndërsa në ciklin e lartë janë 857 mësues gjithsej nga të cilët 450 janë femra.

Grafik 2. Raporti mesuese/mësues ne CU Diber 2011

Burimi DAR Dibër



Në qarkun e Dibrës në ciklin e ulët punojnë gjithsej 699 mësues dhe mësuesesh në të tre rrethet. Numri i mësuesve është 249, ndërsa mësuese janë gjithsej 450.

Një situatë e ngjashme vihet re edhe në ciklin e lartë. Në total në qark japin mësim gjithsej 857 mësimdhënës, nga të cilët 450 janë mësuese dhe 407 janë mësues.

Siç është përmendur, Dibra ka një shtrirje të mire të strukturave të sistemit arsimor. Gjithashtu përqindja e lartë që zë grupmosha “fëmijë” ka diktuar gjetjen e mundësive për të rritur aksesin e të gjithë fëmijëve në arsimim. Përgjithësisht vihet re edhe rritja e vëmendjes së prindërve për të investuar në një shkollim sa me cilësor të fëmijëve. Vlerësimet pozitive për mësuesit në disa raste janë të dukshme.

Kjo është edhe arsyeja pse ka frekuentim të nxënësve nga fshatrat jo në shkollat në komunat e tyre por në bashki/qytet.

Megjithëse janë bërë përpjekje të vazhdueshme që çdo fëmijë të ndjekë shkollën, përsëri braktisja ekziston si problem. Si qark 21 nxënës kane braktisur shkollën në ciklin e ulët gjatë vitit 2011 . I shprehur në përqindje ky tregues në CU është në masën 0.33 %. Nga ky kontingjent 13

¹⁹ DAR Diber, Statistika 2011, Dhjetor 2012

nxënës (ose *0.14 %*) *janë vajza*. Ndërsa në ciklin e lartë kanë braktisur shkollën *75 nxënës* (ose *0.58 nxënës*), nga të cilët *53 (ose 0.83 %)* *janë vajza*.

Padyshim jo të gjithë nxënësit janë të suksesshëm me rezultatet e tyre në fund të procesit mësimor. Gjatë vitit 2011 në Dibër janë regjistruar *23,263 nxënës* në arsimin e detyruar dhe *7,497 nxënës* në arsimin e mesëm. Nga këta rezultojnë përsëritës *272 nxënës* në arsimin e detyruar nga të cilët *107 janë vajza* dhe *165 janë djem*. Ndërsa në arsimin e mesëm janë *193 nxënës* përsëritës, nga të cilët *29 janë vajza* dhe *164 janë djem*.

Për grupmoshën 0-6 vjeç në Dibër funksionojnë 7 çerdhe në të cilat shërbejnë 75 edukatore, *173 kopshte* në të cilat ofrojnë shërbimin për këtë grupmoshë *260 edukatore*. Çerdhet janë në qytete në secilin rreth dhe kanë akses në to *249 fëmijë 0-3 vjeç*²⁰.

IV - Prezantimi I gjetjeve kryesore

- Një pjese e të dhënave nuk është e mundur të prodhohen në nivel lokal. Ky problem fillon që nga evidentimi i numrit të fëmijëve në nivel njësie vendore. Mungesa e këtij informacioni në këtë nivel, e bën të vështirë nxjerrjen e numrit total të fëmijëve në nivel qarku. Një gjë e tillë vështirëson gjithë punën e mëtejshme në monitorimin e respektimit të të drejtave të fëmijëve pasi nuk mund të matet niveli i aksesit.
- Edhe për të dhënat për të cilat ka informacione, të marrë nga struktura të ndryshme ato paraqitet në vlera jo të njëjta. Megjithëse nga DPGJC ne si observator marrim informacion mbi numrin e personave në regjistrat e gjendjes civile, ky numër *nuk* është i njëjtë me numrin e personave që banojnë vërtetë në zonat përkatëse për të cilët duhet të planifikohen shërbime dhe të matet aksesit i komuniteteve ndaj këtyre shërbimeve.
- Pavarësisht se zhvillojnë aktivitetin e tyre brenda një njësie vendore, varësia në nivel vendor është sektoriale dhe *në linje hierarkike nga poshtë - lartë*. Kjo do të thotë që secila ministri ka strukturat e veta në çdo njësi vendore, por këto struktura nuk operojnë si pjesë e aktivitetit të komunave dhe nuk kanë detyrime ndaj drejtuesve të njësisë vendore, pavarësisht se ofrojnë shërbime për të njëjtën popullsi. Kjo është një ndër arsyet pse vetë njësitë vendore nuk kanë informacion për të gjitha çështjet që lidhen me popullsinë dhe territorin e saj.
- Varfëria absolute është një problem që ndeshet në qarkun e Dibrës. Përjashtimi social sidomos për fëmijët e këtyre familjeve bën që atyre t'ju privohen pothuaj të gjitha të drejtat. Megjithatë nuk ka informacione numerike bazë mbi të cilët të përcaktohet numri i këtyre familjeve dhe fëmijëve.
- Përveç politikave të mbështetjes në aspektin financiar, në qarkun e Dibrës nuk ka mbështetje tjetër konkrete me shërbime për fëmijët me nevoja të veçanta.
- Punësimi i fëmijëve ndeshet në rrethin e Dibrës dhe në disa raste ato janë të ekspozuar ndaj një shkalle të lartë rreziku. Niveli i ulët ekonomik në zonë dhe të ardhurat e pakta që sigurohen nga punësimi, bëjnë që fëmijët të llogariten si forca potenciale pune brenda familjes, megjithëse për shkak të moshës ato nuk janë të tillë.
- Roli i prinderve në bashkëpunimin me shkollën nuk është në përputhje me detyrimet e ndersjellta të parashikuara në "DISPOZITA NORMATIVE" për "Për arsimin parauniversitar", në KREU X "PRINDERIT", neni 47 "Te drejtat, detyrimet", pikat **d** dhe **e** në të cilat thuhet që:

²⁰ DAR Statistika 2011, Diber 2012

- d) të respektojnë të drejtat e fëmijëve dhe të ndihmojnë në edukimin e tyre;
- e) të vendosin kontakte të rregullta me mësuesit e fëmijëve të tyre;
- Fëmijët që jetojnë në familje që mbështeten me ndihme ekonomike dhe që drejtohen nga kryefamiljare gra jetojnë në një shkallë të konsiderueshme përjashtimi social, për shkak të mundësive të kufizuara financiare brenda familjeve të tyre.
- Sidomos në shkollat e mesme vihet re jo vetëm pirja e duhanit, por dhe përdorimi i substancave të ndaluara të kategorisë së drogave të ndryshme.

V - Rekomandime

- Marrëveshjet e nënshkruara mes ministrive në nivel qendror duhet të përcillen edhe në nivel rajonal dhe lokal, duke bërë të mundur detyrimin e shkëmbimit të informacioneve dhe ndarjen e të dhënave duke filluar nga niveli i njësisë vendore.
- Nxitja e politikave të punësimit në nivel vendor është i domosdoshëm për rritjen e mundësive për respektimin e të drejtave të fëmijëve nga familja dhe komuniteti. Gjithashtu një gjë e tillë redukton përjashtimin social dhe pabarazinë mes fëmijëve.
- Duhet ndërhyrje urgjente nga njësitë vendore dhe strukturat e tjera lokale rajonale për të mos lejuar fëmijët të punojnë në proces pune me rrezik shumë të lartë, punë në të cilat sipas të dhënave nga vitet e kaluara ka pasur raste të humbjes së jetës së personave edhe të rritur.
- Gjetja e mënyrave dhe mekanizmave që sigurojnë partneritetin real dhe funksional të prindërve dhe shkollës me synim mbarëvajtjen sa më të mirë të fëmijëve në procesin mësimor dhe në gjithë edukimin e tyre.
- Identifikim i saktë i problemeve të fëmijëve në NE dhe që kanë kujdesie prindërore nga nënat dhe programe përfshirje për këtë kategori fëmijësh. Kjo pasi për shkak të mentalitetit nënat nuk mund të luajnë njëkohësisht edhe rolin e babait, pavarësisht dëshirave të tyre.
- Më shumë vëmendje ndaj përdorimit të drogës nga nxënësit e shkollave sidomos atyre të mesme. Të konsiderohet si tabu dhe të mos flitet për të, nuk do të thotë që këto probleme nuk ekzistojnë.

Bibliografia

- Ligji 10347, date 4.11.2011 “ Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”
- VKM 265, date 12.4.2012 “Për krijimin dhe funksionimin e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve shtetërore, përgjegjëse për referimin e rasteve të fëmijëve në rrezik, si dhe mënyrën e procedimit të tij”.
- VKM 266, date 12.4.2012 “Për bashkërendimin e veprimtarisë së mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështje që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”
- Treguesit e rinj sipas listës së miratuar me VKM 267, datë 12.04.2012
- Ligjin ", nr. 7952, datë 21.06.1995, "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar” ndryshuar me Ligjin nr. 8381, datë 30.07.1998 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7952 “Për sistemin Arsimor Parauniversitar”.
- Ligji Nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”.
- Profili i varfërisë së fëmijëve në Shqipëri, A. Ceni, UNICEF 2011
- Raportet vjetore të përgatitura nga Observatori Dibrë për vitet 2008,2009,2010
- Raportet kombëtare 2008, 2009 dhe 2010, të përgatitur nga Observatori Tiranë
- Të dhëna statistikore mbi popullsinë, të dërguara nga Zyra e Observatorit Tiranë
- NJMF Peshkopi, Raporti vjetor 2011
- World Vision studim “ Raport vlerësimi për situatën e mjedisit te shëndetshëm dhe paqësor për fëmijët në rajonin e Dibrës” mars – prill 2010
- Matja e mirëqenies në Shqipëri duke përdorur vrojtimet MICS dhe ADHS, V. Kolpeja